

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me zyrtaren ligjore Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të akuzuarit M. K. nga Gj, për shkak të veprës penale vjedhja e pyellit, nga neni 358 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II nr.2035/16 e datës 04.11.2016, të cilën e përfaqësonte prokurori Shefik Mehmeti, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 20.04.2017, mori dhe shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari M. K, nga babai R dhe nëna S, e lindur D i lindur më në fshatin Twrstenw k.e Kamenicws , e tani me vendbanim në nw shtwpi tw romwve shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar,babë i tre fëmijve të mitur, i papunë, i gjendjes së varfur ekonomike,shfrytzues i skemave sociale me kartelen nr.27-981, i ka të kryer 8 vite të shkollës fillore, nuk ka qenë i dënuar me parë për ndonjë vepër tjetër penale,

Është fajtor

Sepse më datën 25.10.2016, rreth orës 18.00 h, në territorin e fshatit Përlepnice, në pyellin e pronësisë shtetwrore, në vendin e quajtur “”, i pandehuri wshtw taku duke i prej ..duke i bartur me makinë “...”(...), në këtë mënyrë të dëmtuarës-APK-së zyra në Gjilan, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej përfaqësimit 271.36 Euro.

- me çka ka kryer veprën penale vjedhje pyelli nga neni 385 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të nenit 4,17,21,49,50,51,52, dhe 73 të KPRK, si dhe nenit 365,453 e 463 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarit, i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 100 (njëqind) ditëve, të cilin dënim i akuzuari nuk do ta mbajë, nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë nuk kryen veprë tjetër penale.

APK-Zyrja komunale në Gjilan për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontestin civil.

Shpenzimet lidhur me këtë lëndë penale, bien në barrë të kësaj gjykate, pasi që i njejti është i gjendjes së mjerueshme ekonomike-shfrytëzues i skemës sociale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarit nga Gj, për shkak të veprës penale vjedhja e pyellit nga neni 385 paragrafi 1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 20.04.2017, prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, Shefik Mehmeti, gjatë fjalës përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës së lartcekur, duke i propozuar gjyqtarit të vetëm gjykues që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

I akuzuari, gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se më vjen shumë keq për rastin e ndodhur. Pohoi se është babë i tre fëmijëve të mitur-nxënë, se bashkëshorten e ka të sëmurë nga kanceri, është nën terapinë e rrezatimit, jetojnë në bashkësi familjare me 13 antarë, pa asnjë të punësuar, hera e parë që ndeshet me ligjin, andaj kërkoi që atij ti shqiptohet një dënim sa më i butë e eventualisht i kushtëzuar, drut i kishte për nevojë të veta e jo për shitje.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, pas leximit të aktakuzës, i akuzuari, ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale e cila më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit edhe të prokurorit dhe mbrojtësit, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni , nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i akuzuari kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pas konsultimeve me mbrojtësin e tij; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i akuzuari dhe çdo provë tjetër, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i akuzuari, me dije dhe dashje ka kryer veprën penale vjedhja e pyellit nga neni 385 paragrafi 1 të KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues, e shpalli fajtor të akuzuarin, për shkak të veprës penale vjedhja e pyellit nga neni 385 paragrafi 1 të KPRK-së ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjyqtari i vetëm gjykues e ka marrë për bazë faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë; se është penduar dhe ndjen shumë keqardhje për rastin e ndodhur; se i ka premtuar gjyqtarit të vetëm gjykues që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale; se i akuzuari është i papunë dhe ka gjendje të varfur ekonomike,gruan e sëmurë nga kanceri, që kërkon trajtim të shtrejtë mjekësor, jeton me ndihma sociale me kartelën nr.27981 kopja e sw cilws gjendet nw shkresat e lwndws,me familjen 13 antarëshe pa asnjë të punësuar,si dhe fakti se vepra është edhe para parashkrimit absolut, poashti si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese, pos dëmit të shkaktuar APK-së.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht, ndaj të akuzuarit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 50 të KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451-454 paragrafi 1 ndërsa ai mbi kërkesën pasurore-juridike, është bazuar në nenin 463 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

Më 20.04.2017

**Zyrtarja ligjore,
Florentina Ademi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Azizi**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.